

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Seanca plenare**

Seanca nr. 02-18/05-06

Prishtinë, më 16 mars 2006

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e drejtoi **Kolë BERISHA**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Mahir Yagcilar**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 88 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendit i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE:**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veprimtarinë botuese dhe librin,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për konfliktet administrative,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për efikasitetin e energjisë,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave,
8. Shqyrtimi i kërkesës së grupit parlamentar të Partisë reformiste ORA, për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare,
9. Shqyrtimi i Rekomandimit të komisionit për çështje gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për miratimin e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
10. Propozimi i rendit të ditës për Seancën Plenare më 24 mars 2006:
  - Shqyrtimi i raportit të Grupit Negociator për bisedimet në Vjenë.

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit për qëllimin dhe rendin e ditës së kësaj seance.

Në fillim të seancës për fjalë u lajmëruan këta deputetë:

**Gani Koci** (PDK) pati vërejtje që deputetëve po u shpërndarjen materialet e seancave me vonesë.

**Nimon Alimusaj** (LDK), kërkoi që Kuvendi sa më parë ta shqyrtoi Projektligjin për institucionet e kulturës.

**Fetah Berisha** (LDK) kërkoi që imuniteti i deputetëve të Kuvendit të rregullohet me kartela identifikimi (IT) të veçanta.

**Sabit Rrahmani** (PDAK) kërkoi që të respektohet marrëveshja nga Këshilli Konsultativ për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komuniteteve në bisedimet e Vjenës.

**Emrash Xhemajli** (LPK) kërkoi që IPVQ-të e Kosovës të ndikojnë tek PSPP-ja që veprimtari, **Naser Shatri**, i arrestuari në Austri nga Interpoli, me kërkesë të MPB të Serbisë, të mos ekstradohet në Serbi, si dhe debati për takimin e Vjenës të mos shtyhet për seancën e radhës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kuvendi** miratoi rendin e ditës të kësaj seance, në formën e propozuar nga Kryesia e Kuvendit.

### **2. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme**

Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare të 10 marsit 2006.

### **3. Shqyrtimi i dytë i Projektligji për veprimtarinë botuese dhe librin**

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

**Kuvendi** i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 21, 22, 23 dhe 24.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin dhe amendamentet e miratuara. Rezultati ishte:

Për-----85;

Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash **miratoi** Ligjin për veprimtarinë botuese dhe librin.

#### 4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për konfliktet administrative

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9,10,11, 12, 13, 14, 15 dhe 16.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 76.

Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës njëzëri **miratoi** Ligjin për konfliktet administrative.

**Kryetari dha pauzë pesmbdhjetë minuta.**

Pas pauzës, seanca i vazhdoi punimet me shqyrtimin e parë të projektligjeve.

#### 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për efikasitetin e energjisë

**Kryetari** e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

**Zëvendësministri Agron Dida**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, zëvendësministri **Dida** shpjegoi materien, objektivat, mënyrën e realizimit, efektet buxhetore, si dhe faktorët kryesorë për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri **Dida**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ibush Jonuzi, Bajrush Xhemajli, Genc Gorani, Mazllun Kumnova, Xhezair Murati, Ferid Agani dhe Gani Koci**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Në fund të debatit, zëvendësministri **Dida** iu përgjigj vërejtjeve të diskutuesve.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 45;

Kundër-----37..

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash **miratoi në parim** Projektligjin për efikasitetin e energjisë.